

23/06/2025
02/185

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (s), nenit 40 paragrafit 40.2 shkronja (h), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 Qershor 2008, bazuar në nenin 11 paragrafi 11.1, nenit 23 paragrafi 23.7 shkronja (i), të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2024, propozimit nr.01/691 datë:11.06.2025 të Kryetarit të Komunës, në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme me datë: 13.06.2025 merr këtë:

VENDIM

**Për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Malishevës
z.Halil Kastrati**

1. Z.Halil Kastrati, i jepet titulli **"Qytetar Nderi"** i Komunës së Malishevës, me motivacion:

"Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në përmirësimin e kushteve ekonomike e sociale për familjet në nevojë në të gjitha trojet shqiptare, me theks të veçantë në Komunën e Malishevës".

2.Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Malishevës,të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Malishevës.

4.Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës,ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar,me Rregulloren (QRK) nr.06/2021,përkatësisht pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
MAPL-së
Arkivit të Komunës

